



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2472/4 prot

Datë 24.11.2022

V E N D I M
Nr.1151/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.11.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-45190-10-11-2022, me objekt: “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve”, me fond limit 7,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime SHA, Durrës.

Ankimues: “Primus Albania” SHPK.
Adresa: Rr. “Margarita Tutulani”, Pallati Viridario 1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Ujësjetllës Kanalizime SHA, Durrës
Rr. “Dalip Peza”, Durrës

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për

Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.10.2022, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-45190-10-11-2022, me objekt: “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve”, me fond limit 7,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime SHA, Durrës.

II.2 . Në datën 24.10.2022 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 28.10.2022 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), si më poshtë:

1- "Primus Albania" SHPK	4,999,000	skualifikuar.
2- "A-T-D Albania Technology Distribution" SHPK	6,999,600	kualifikuar.

II.4. Në datën 28.10.2022 operatori ekonomik "Primus Albania" SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

• *OE nuk përmbush piken 2.4.1 të kriterëve të veçanta për kualifikim, pasi nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi apo distributori i autorizuar ose ekuivalent i zgjidhjes "flare billing" dhe "Mobiread" që janë zgjidhjet në përdorim në UKD. Dokumenti "Autorizim prodhuesi" me nr. rep 1094 date 18.06.2020 është lëshuar vetëm për objektin dhe autoritetin UKT të cituar në autorizim, pra rrjedhimisht autorizimi nuk është i vlefshëm.*

II.5. Në datën 03.11.2022 autoriteti kontraktor ka kryer publikimin e njoftim të fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 09.11.2022, operatori ekonomik ankimues "Primus Albania" SHPK, ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e tij të skualifikimit.

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2472/2 prot., datë 10.11.2022, u publikuan kriteret e skualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimues "Primus Albania" SHPK pretendon se i plotëson.

II.8. Me shkresën nr. 7104/25 prot., datën 15.11.2022, protokolluar me tonën me nr. 2472/3 prot., datë 18.11.2022, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik "Primus Albania" SHPK, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke njoftuar operatorin ekonomik dhe duke vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik.

II.12. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr.162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Primus Albania” PF, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “[...]OE nuk përmbush piken 2.4.1 të kriterëve të veçanta për kualifikim, pasi nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi apo distributori i autorizuar ose ekuivalent i zgjidhjes "flare billing" dhe "Mobiread" që janë zgjidhjet në përdorim në UKD. Dokumenti "Autorizim prodhuesi" me nr. rep 1094 date 18.06.2020 është lëshuar vetëm për objektin dhe autoritetin UKT të cituar në autorizim, pra rrjedhimisht autorizimi nuk është i vlefshëm. Duke ju referuar pikave 3 dhe në veçanti pikës 4 të nenit 36, është shumë e qartë se termi ekuivalent në këtë rast përdoret dhe shoqëron produktin ose shërbimet e kërkuara/ofruara dhe jo dokumentin autorizim nga prodhuesi apo distributor i autorizuar në rastin konkret që përdoret për produktet apo shërbimet. Pra siç ju theksoni në ToRs, Mobired është sistem operimi funksional, me të cilin operojnë një tip i caktuar lexuesish në terren (PDA) dhe nuk është aplikacion program kompjuterik (soft) i pavaruar nga pajisja ku implmentohet dhe të mund të implementohet në pajisje të tjera të ngjashme. Së pari autorizimi që ju citoni “"Autorizim prodhuesi" me nr. rep 1094 date 18.06.2020 është lëshuar vetëm për objektin dhe autoritetin UKT të cituar në autorizim, pra rrjedhimisht autorizimi nuk është i vlefshëm” është autorizim prodhuesi për pajisje lexuesi PDA dhe jo për sistem operimi funksional që ka të integruar vetë pajisja. Pra, kjo vërteton dhe një herë faktin e sipërcituar nga në që autorizimi i prodhuesit mund të kërkohej/lëshohet për vetë pajisjet në tërësi përfshi dhe sistemin operativ me të cilin funksionon ajo pajisje dhe jo vetëm për sistemin operativ të pajisjes [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kërkesa të tjera të veçanta për Kualifikimit”, pika 2.4.1 i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.4.1 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar ose ekuivalent i zgjidhjes "FLARE BILLING" dhe "MOBIREAD" që janë zgjidhjet në përdorim. Ne rast të paraqitjes së autorizimit nga distributor i autorizuar të vertetohet lidhja mes prodhuesit dhe distributorit të autorizuar.*

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik "Primus Albania" SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Autorizim prodhuesi me numër Rep 1094, datë 18.06.2020
- Certifikatë të regjistrimit të së drejtës së autorit, datë 27.11.2011.

III.1.3 Me shkresën nr. 7104/25 prot., datën 15.11.2022, protokolluar me tonën me nr. 2472/3 prot., datë 18.11.2022, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik "Primus Albania" SHPK, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke njoftuar operatorin ekonomik dhe duke vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik me argumentet si vijon: "[...] *Mobired dhe Flare Billing nuk janë sisteme operimi për PDA, por për pajisje si PC, laptop, Printer etj. Zgjidhjet Flare Billing dhe Mobired janë sisteme informatike të gatshëm, të konfiguruar të përdoren nga UKD, të integruara mes tyre dhe përfshijnë ndër të tjera module: server, ueb për specialistët në zyrë, mobile për PDA e përdorur për specialistët në terren. Flare Billing dhe Mobired janë zgjidhje të pavarura nga pajisja PDA.*

III.1.4. Në nenin 2 "Qëllimi" të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se: "Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."

Ndërkohe në nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se:

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar

artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

III.1.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga

operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 *“Për prokurimin publik”* ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprimet me transparencë e në mënyrë proporcionale. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i tyre, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose nga distributori i autorizuar ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar ose ekuivalent i zgjidhjes "FLARE BILLING" dhe "MOBIREAD" që janë zgjidhjet në përdorim. Në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributor i autorizuar të vertetohet lidhja mes prodhuesit dhe distributorit të autorizuar..* Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit ka paraqitur: 1. Autorizim prodhuesi me numër Rep 1094, datë 18.06.2020 dhe 2. Certifikatë të regjistrimit të së drejtës së autorit, datë 27.11.2011.

Referuar arsyes së skualifikimit për operatorin “Primus Albania” SHPK, shqyrtimit dhe verifikimit të dokumenteve të tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK në sistemin e prokurimeve elektronike në lidhje me përmbushjen e kriterit të parashikuar në pikën 2.4.1, si dhe verifikimit të kryera, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autorizimi i prodhuesit me numër Rep 1094, datë 18.06.2020, nuk është në përputhje me kriterin e kërkuar. Operatori ekonomik përveç se pretendimeve që *Mobired është sistem operimi funksional, me të cilin operojnë një tip i caktuar lexuesish në terren (PDA) dhe nuk është aplikacion program kompjuterik (soft) i pavarur nga pajisja ku implementohet dhe që mund të implementohet në pajisje të tjera të ngjashme*, nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion që vërteton që zgjidhjet "FLARE BILLING" dhe "MOBIREAD" që autoriteti kontraktor ka në përdorim, janë

pjesë integrale dhe funksionale të pajisjes dhe ofrohen të implementuara në pajisjen PDA. Në rastin konkret Komisioni vlerëson, se autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit nuk ka kërkuar pajisje PDA apo mirëmbajtjen e pajisjeve PDA, apo autorizim për pajisjet, por autorizim për zgjidhjet që ka në përdorim, që janë Mibiread dhe Flare Billing. Komisioni i Prokurimit Publik shton, se është në të drejtë të autoriteteve kontraktore të vendosin kritere të veçanta për kualifikim, që janë propocionale me objektin e kontratës dhe që i japin garanci autoritetit kontraktorë për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK, nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur e thjeshtuar”*, me Nr. REF-45190-10-11-2022, me objekt: “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve”, me fond limit 7,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime SHA, Durrës.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova